

## U D H E Z I M

Sot me dt. 06.04.1999, unë Prokurori i Përgjithshëm Arben Rakipi, me qëllim për te unifikuar qëndrimet e prokuroreve në kërkesat e tyre për dënimet e te pandehurve, që kërkojnë gjykim të shkurtuar për te parandaluar zbatimin e gabuar të ligjes kur behet fjale për zhvillimet e gjykimeve të shkurtuara, për te ndikuar në kuptimin e dispozitave që bëjnë fjale për uljen e dënimit nën minimumin e parashikuar nga Ligji, bazuar në nenin 24 të Kodit të Procedurës Penale

### UDHËZUJ:

1. Në praktiken gjyqësore janë vënë re mjaft raste kur është proceduar me gjykim të shkurtuar edhe në mungesë të te pandehurit. Sipas neneve 403 deri 406 të Kodit të Procedurës Penale rezulton se në asnjë rast nuk duhet pranuar një gjykim i tillë pa praninë e te pandehurit. Në këto kushte nga ana e prokuroreve duhet bërë kujdes për te zbatuar me korrektësi ligjin procedural penal dhe, në rastet kur nga gjykatat do të pranohet një gjykim i tillë, të bëjnë Apel edhe vetëm për këtë shkak.
2. Në rastet kur, pas pranimit të një gjykimi të shkurtuar sipas kërkesave të ligjes, vetë i pandehuri do të bëjë ankim kundër vendimit të gjykatës së shkalles së parë, prokuroret e apeleve apo pranë Gjykatës së Lartë duhet të kundërshtojnë ankimin vetëm për këtë fakt.
3. Është vënë re në kërkesat e fundit në gjykimet e shkurtuara të prokuroreve që aplikimi i dënimit në mjaft raste është i gabuar, veçanërisht kur dënimi ulet nën minimumin e dispozitës përkatëse të Kodit Penal të dënimit me burgim.  
Neni 406 i Kodit të Procedurës Penale nuk është dispozite materiale penale dhe nuk shprehet dhe nuk mund të shprehet për uljen e dënimit nën minimum, por flet vetëm për uljen me 1/3 e dënimit.  
Në rastet kur minimumi i dënimit me burgim është i përcaktuar në një dispozite të Pjesës së Posaçme të Kodit Penal, tregon që vepra penale është rrezikshmerisht e lartë dhe, në këto raste duhen rrethana të tjera të caktuara, tej atyre që duhen për gjykimin e shkurtuar, për te ulur dënimin nën minimum. Dhe këto rrethana apo kritere jepen në nenin 53 të Kodit Penal që lejon rastet kur dënimi mund të ulet nën minimum.

Pra, pa u vërtetuar rrethanat e nenit 53 të Kodit Penal, në asnjë rast dënimi që rrjedh nga një gjykim i shkurtuar nuk mund të ulet nën minimumin e parashikuar nga ligja. Aplikimi i dënimit nën minimum për një gjykim të shkurtuar, bie ndesh me paragrafin e dytë të nenit 2 të Kodit Penal ku thuhet: "Askush nuk mund të dënohet me një lloj dhe mase dënimi të pa parashikuar në ligj".

Për sa kohë, në raste të tilla nuk janë vërtetuar kriteret e kërkuara nga neni 53 i Kodit Penal dhe nuk është aplikuar ai, dënimi i të pandehurit nën minimumin e dënimit të dhënë nga ligja, është bërë me "mase dënimi të paparashikuar në ligj" (neni 2/2 i Kodit Penal).

Për të kërkuar një dënim për të pandehur që pranojnë gjykim të shkurtuar, akuzuar për një veprë penale që dispozita përkatëse e Kodit Penal përmban minimum të përcaktuar, është e domosdoshme të kërkohet jo minimumi i dënimit, por më lart se ai edhe për faktin tjetër se të gjitha veprat penale me minimum të përcaktuar janë me rrezikshmëri të lartë shoqërore, vlerësim që është bërë nga Ligjvënësi dhe nuk behet nga prokurori apo gjykata.

Këta të fundit mbetet të bëjnë vetëm individualizimin e dënimit sipas dhe brenda kriterëve të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal.

4. Ky udhëzim të punohet në kolektivat e prokuroreve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të të gjitha shkalleve dhe të njoftohet Drejtoria e Hetimit dhe ajo e Kuadrit për punimin e tij.

5. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

PROKURORI I PËRGJITHSHEM

ARBEN RAKIPI



